



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 33, datë 28.02.2022

**MBI
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË DHE ZGJERIMIT TË LICENCËS SË
SHOQËRISË “BANKA CREDINS” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Ligji nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, në nenin 377, pika 1, parashikon se: *“Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji”.*

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën është licencuar, banka duhet të përshtatet me kërkesat dhe kushtet e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Aktualisht “Banka Credins” sh.a., mban licencën nr. 8/1, datë 19.12.2019 për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj (broker-dealer) në “Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE” dhe në tregun me pakicë në Republikën e Shqipërisë, si dhe licencën nr. 4, datë 30.08.2010 dhe licencën nr. 1, datë 13.12.2011 për të vepruar respektivisht, si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH dhe kujdestar i obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore. Licencat janë lëshuar sipas dispozitave të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, i shfuqizuar.

Licenca që mban “Banka Credins” si shoqëri brokerimi (broker- dealer) për titujt që tregëtohen në bursë dhe tregun me pakicë të R.SH, nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara, sipas Ligjit nr. 62/2020, është e njëjtë me shërbimet e investimit:

- Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit;
- Ekzekutim urdhërash; dhe
- Tregtim për llogari të vet

Nga pikëpamja e instrumenteve financiare, licenca është e njëjtë me instrumentet e mëposhtme:

- Titujt e transferueshëm;
- Instrumente të tregut të parasë; dhe
- Kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive..

Ofrimi i shërbimit të kujdestarisë në titujt e Qeverisë Shqiptare dhe kujdestarisë së obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore, sipas Ligjit nr. 62/2020 konsiderohet shërbim ndihmës (shërbimi i kujdestarisë apo ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve).

Me qëllim përshtatjen e veprimtarisë, shoqëria “Banka Credins”, ka depozituar në Autoritet raportin e përshtatshmërisë, sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar.

Shoqëria “Banka Credins” sh.a. ka depozituar, gjithashtu, kërkesën dhe dokumentacionin për zgjerimin e licencës me qëllim ofrimin e shërbimeve shtesë të investimit, si dhe shërbimeve ndihmëse.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I:

1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Banka Credins” sh.a. sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij për:

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit:

- **Marrje dhe transmetim i urdhrave;**
- **Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve; dhe**
- **Tregtim për llogari të vet.**

Për instrumentet financiare:

- **Titujt e transferueshëm;**
- **Instrumentet e tregut të parasë;**
- **Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.**

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në instrumentet e mësipërme si:

- **Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.**

2. Miratimin e zgjerimit të licencës së shoqërisë “Banka Credins” për:

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit:

- Nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare në bazë të angazhimit në transaksion;
- Hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje.

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës:

- Këshillimi i shoqërive tregtare në lidhje me strukturën e kapitalit, strategjinë industriale dhe çështjet e lidhura me to, këshillimi e ofrimi i shërbimeve për bashkimin dhe blerjen e shoqërive tregtare.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE